



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2018, ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””
3. Projektvendim "Për fillimin e procedurave paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Roland Xhelilaj, Reme Lala, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Benet Beci – Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së kësaj mbledhje kemi shqyrtimin e dy çështjeve:

Së pari, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””.

Së dyti, projektvendimin "Për fillimin e procedurave paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".

Për çështjen e parë ndodhet në komision zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Elton Haxhi, si dhe drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, agjencia që praktikisht ekzekuton kreditë, zoti Benet Beci.

Relator i komisionit, për çështjen e parë është zonja Antoneta Dhima.

Fjalën e ka zoti zëvendësministër, pastaj do të vazhdojmë me relatoren e komisionit.

Elton Haxhi – Faleminderit, kryetar!

Para jush kemi sjellë ratifikimin e marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”. Aktualisht kërkojmë ndryshimin e nenit 3 pika 2 të marrëveshjes, ku përcaktohet shtyrja e afatit të fundit të disbursimit të fondeve deri në datën 30 tetor 2018, në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Aktualisht ka ngelur pa u disbursuar vlera që i referohet supervizorit të kontratës, pra konkretisht është pagesa përfundimtare e garancisë prej 5% të vlerës së kontratës së supervizorit. Koha për disbursimin e kësaj vlere i tejkalon afatet e parashikuara në marrëveshjen e ndryshuar. Ju kujtoj se kjo marrëveshje është ndryshuar një herë, pra është shtyrë afati, por për shkak të pagesës së garancisë duhet shtyrë edhe një herë deri në datën 30 tetor 2018, ku do të kryhet edhe pagesa përfundimtare.

Përveç kësaj, kërkohet edhe një ndryshim i emrit, për shkak të ristrukturimit të institucionit, pra nga Ministria e Financave të bëhet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Dhima

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””, është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81 pika 1 dhe 100 të Kushtetutës dhe nenet 17 dhe 23 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji i miratuar në parim me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 11.07.2018 ka për qëllim ratifikimin e ndryshimit të dytë të marrëveshjes së huasë dhe programit, i cili është miratuar me ligjin nr. 10407, datë 31.03.2011.

Marrëveshja e bërë në mars të vitit 2011 do të siguronte një hua prej 20 milionë eurosh të dhëna nga qeveria gjermane nëpërmjet KfW-së, që është institucioni financiar përmes të cilit parashikohet të livroheshin fondet për të bërë të mundur realizimin e programit “Fondi i Investimeve Sociale IV”. Ky program kishte si qëllim rritjen e aksesit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës rurale në rajonet veriore të Shqipërisë, në qarqet, si: Shkodër, Kukës dhe Dibër, duke parashikuar rehabilitimin, rindërtimin apo ndërtimin nga e para të sistemeve të furnizimit me ujë të kanalizimeve, si dhe të rrjetit rrugor rural.

Gjithashtu, ky program do të bashkëfinancohej nga Bashkimi European nëpërmjet një granti, nga fondet IPA 2009, prej 8 milionë e 820 mijë eurosh, i cili parashikohet nga KfW-ja.

Në vitin 2014 me ligjin nr. 139 u miratua edhe ndryshimi i parë në dokumentet e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të fundit për disbursimin e huasë, akorduar nga KfW, nga data 30.12.2013 deri në datën 30.06.2017 me pretendimin që periudha e mbetur nga përfundimi i projekteve teknike deri në përfundimin e afatit të disbursimit ishte e pamjaftueshme për disbursimin e fondeve të papërdorura në kuadër të këtij programi.

Projektligji që po shqyrtojmë sot kërkon amendimin e pikës 2 të nenit 3 ku kërkohet shtyrja e afatit të disbursimit nga data 30.06.2017 deri në datën 30 tetor 2018. Ndryshimi i këtij afati do të bëjë të mundur kryerjen e pagesës përfundimtare të garancisë me vlerën 5% të kontratës.

Punimet civile të projektit kanë përfunduar për të 7 objektet dhe pas përfundimit të garancisë janë dorëzuar pranë institucioneve të qeverisjes vendore.

Gjithashtu, në tekstin e marrëveshjes njëkohësisht propozohet që të bëhet edhe zëvendësimi i emërimit, siç e tha edhe zëvendësministri, nga Ministria e Financave në emërtimin Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për të dyja ndryshimet është marrë miratimi paraprak i KfW-së.

Meqenëse nëpërmjet këtij projektligji finalizohet një nga programet më të rëndësishme të qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Dhima!

A ka pyetje? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e marrëveshjes.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendim “Për fillimin e procedurave paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Roland Xhelilaj, Reme Lala, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Erion Braçe – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, me projektvendimin “Për fillimin e procedurave paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Siç është njoftuar, 3 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përkatësisht zoti Dhori Kuke, i zgjedhur me vendim nr. 137, datë 03.11.2011; zonja Ela Golemi, emëruar me vendim nr. 138, datë 03.11.2011, dhe zoti Arben Malaj, i zgjedhur me vendim nr. 53, datë 02.07.2016 u ka përfunduar mandati.

Për zotin Malaj dua të theksoj se, sipas Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, i përfundon mandati që ai ka plotësuar dhe që është mandati i zonjës Ermelinda Meksi, votuar me vendim të Kuvendit nr. 139, datë 03.11.2011. Pra, në datën 3 nëntor të këtij viti mandatet e këtyre 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë përfundojnë.

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, neni 111, pika 1, thuhet: “Çdo grup deputetësh, por jo më pak se 28 deputetë, ka të drejtë t’i propozojë Kryetarit të Kuvendit kandidaturat e mundshme për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”. Duke qenë se këta 3 anëtarë janë zgjedhur me propozim nga vetë Kuvendi, grupimet prej së paku 28 deputetësh duhet të propozojnë kandidaturat për 3 vende vakante për t’u shqyrtuar dhe për t’u votuar nga Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në përcaktimet e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe afatet procedurale që përcakton Rregullorja e Kuvendit. Pikërisht për këtë arsye organet e Kuvendit u janë drejtuar me shkresë të gjitha grupeve parlamentare, me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi, por në një hap më pas.

Duke iu referuar edhe precedentëve të mëparshëm, këtij komisioni i propozohet që t’i kërkojë Kuvendit hapjen e garës për kandidaturat e vetofruara, të cilat duhet të kandidojnë për vendet vakante të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Pra, procedura duhet të kalojë nga një thirrje paraprake për çdo individ, që plotëson kriteret e parashikuara në nenin 44 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar, dhe nenin 46 të po këtij ligji “Për Bankën e Shqipërisë”.

Kandidati praktikisht duhet të plotësojë këto kritere bazë:

- a) arsimi i lartë në ekonomik ose juridik
- b) përvojë personale në çështjet financiare dhe bankare
- c) kualifikime profesionale të profilit
- ç) përvojë punë mbi 5 vjet në administratën publike ose në institucionet financiare bankare
- d) të mos ketë pengesa të parashikuara në nenin 47.

Plotësimi i kushteve të papajtueshmërisë së funksionit, bazuar në nenin 46 të ligjit: “Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvendin e Shqipërisë apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionarit, me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë”. Këto janë kriteret bazë të përcaktuara nga ligji. Ndërkohë, për shkak të zhvillimeve dhe normave standarde të vendosura, secili prej kandidatëve ka detyrimin të zbatojë përkufizimet e ligjit për dekriminalizimin. Pra, ata duhet të plotësojnë formularin e vetdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016. Ndaj, në zbatim të këtij ligji, si subjekte të ligjit, duhet ta kenë plotësuar këtë formular në momentin e kandidimit për pozicionin në institucionet e pavarura që zgjidhen nga Kuvendi.

Nga ana tjetër, përsëri në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 26 dhe neni 29, pika 4 i tij, thuhet: “Organet e Kuvendit kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi kandidaturat që zgjidhen nga Kuvendi në zbatim të këtij ligji”.

Pra, kandidatët duhet të plotësojnë edhe dy vetdeklarime të tjera, e para ka të bëjë me dekriminalizimin dhe tjetra ka të bëjë me faktin nëse kanë qenë bashkëpunëtorë ose jo të Sigurimit të Shtetit, ndaj Kuvendit i lind detyrimi që të verifikojë këto të dhëna.

Pikërisht duke zbatuar sa më sipër, i propozoj këtij komisioni të miratojë fillimin e procedurave paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, sipas fazave të mëposhtme:

“1. a) Shërbimet e Kuvendit të shpallin dhe të bëjnë publike vakancën e organit kushtetues nga Kuvendi në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjorë, si dhe pëlqimin e kandidatit me shkrim. Afati i dorëzimit të dokumentacionit të bëhet brenda 15 ditëve nga dita e publikimit.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 10 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare për ditën, orën dhe

mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t'ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

2. Procedura paraprake e propozuar në pikën 1 të këtij vendimi nuk është e detyrueshme për t'u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast, që të paktën 28 deputetë t'i paraqesin Kuvendit një kandidat, që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”.

A ka pyetje lidhur me projektvendimin? Nuk ka.

Për të qenë të qartë, do të ketë dy procedura që do të ndiqen: njërin do ta ndjekë rigorozisht administrata e Kuvendit dhe tjetri do të rimerret në këtë komision në momentin që deputetët do të mbështesin kandidaturat me 8 firma në plotësim të detyrimeve që ka Rregullorja, Kushtetuta dhe ligji “Për Bankën e Shqipërisë”.

Pa asnjë lloj diskutimi që ky komision do të zhvillojë dëgjësën publike dhe do të bëjë verifikimet e tij për secilin prej kandidatëve që do t'i paraqiten nga listat e deputetëve.

Atëherë, hedhim në votim projektvendimin. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky projektvendim i shkon seancës plenare për t'u votuar.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA